



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Për :	Haki Rugova, Kryetar i Komunës së Istogut Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave -MAPL	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Nga:	Shkëlqim Jakupi, U.D i Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 15/05/2018
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Istogut	020-445
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të Komunës së Istogut	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01 Nr.23/2018 paraprak për dhënien në shfrytëzim të Pronës Komunale.
I miratuar më datë: 29.03.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 11.04.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Komuna e Istogut duhet të respektoj Rekomandimin e MMPH-së të datës 11.05.2018 me Nr. 020-445/25 si dhe të ketë parasysh pretendimet pronësore sipas Vendimit të Agjencionit Pyjor të Kosovës të datës 26.05.2017, para fillimit të implementimit të këtij akti. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Za :	Haki Rugova, gradonačelnik Opštine Istog Qaush Balaj, predsedavajući Skupštine opštine Istog	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenenata u opštini Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština /MALS	
Preko:	Ivan Todosijevć, ministar MALS-a, <i>[Signature]</i> Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a <i>[Signature]</i>	
Od:	Shkëlqim Jakupi, rukovodilac Odeljejna za zakonska pitanja i monitorisanje opština, MALS <i>[Signature]</i>	Datum: 15.05.2018. Br.020/445
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Istog	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačleniče,  
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku;

Preliminarna odluka 01 br.23/2018 za davanje na korišćenje nepokretne imovine opštine
Usvojena dana, 29.03.2018. godine
Predložena na razmatranje dana, 11.04.2018. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja gore navedenog akta, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Opština Istog treba da poštuje preporuku MSPP-a od dana, 11.05.2018. godine, sa br. 020-445/25 kao i da razmatra imovinske zahteve u skladu sa odlukom kosovske Agencije za šume od dana, 26.05.2017, pre početka sprovođenja ovog akta. Ministarstvo administracije lokalne samouprave i dalje ostaje na raspolaganju opštine za dalje razjašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNIG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
No. i DOK. (Reg. No.)	02
No. i Proje. (Proj. No.)	0271-2/18
No. i Datoje (Data)	02
Prishtine / Pristina	10.05.18

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samoprave / Administration Ministry of Local Government Administration	
Data (Date)	11.05.2018
Shprehjet e miratimit (Signatures)	-02-020-445/18

Për:	Ivan Todosijeviq, Ministër në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Cc:	Njësia për Administrimin e dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e dokumenteve në Komunë Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	
Përmes:	Albena Reshitaj, Ministre e MMPH-së Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së	
Nga:	Sabrije Rama, u.d.Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Data: 02.05.2018
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Ministër,  
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:



**Vendimi paraparak i Kuvendit të Komunës së Istogut 01 Nr. 23/2018 datë 29.03.2018, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale .**

I miratuar me datë: 29.03.2018

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 11.04.2018



I dërguar për shqyrtim në MMPH, me datë: 24.04.2018

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se nuk është kompetente për shqyrtimin e aktit të komunës lidhur me këtë çështje.

Vendimi në preambul nuk e ka bazën ligjore që është në kompetencë të kësaj ministrie, andaj, konstatojmë se MMPH - **nuk është kompetente** për shqyrtimin e aktit të komunës, lidhur me këtë çështje.

Rekomandim : Për shfrytëzimin e gurit gëlqeror duhet nënshtruar procedurave sipas Ligjit Nr. 03/L.-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. ( VNM-së) në MMPH.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbetet në dispozicion të MAPL dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	<b>KUVENDI I KOMUNËS          SKUPŠTINA OPŠTINE          MUNICIPAL ASSEMBLY</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.23/2018	Data: 29.03.2018	


Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe neni 40 paragrafi 40.2 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008). dhe në pajtim me nenin 33. Paragrafi 33.1. pika 11) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10. dhe në bazë të nenit 3 paragrafi 1.3 dhe pika 1.11 neni 5 si dhe neni 7 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, Nr. 04/L-144, dhe Rregulloren QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, në mbledhjen e mbajtur më: 29.03.2018, shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të patundshmërisë komunale afatshkurtër mori:

### V E N D I M

#### PARAPRAK PËR DHENJËN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE

1. Sipërfaqja prej 9371m<sup>2</sup> nga njësia kadastrale nr: 000256-2, në zonën kadastrale Vrellë, e evidentuar me numër të certifikatës 1799/2018 si Pronë shoqërore – shfrytëzues e mirë e fshatit Vrellë, të epet në shfrytëzim afatshkurtër, për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim.
2. Afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite.
3. Obligohet Komisioni Vlerësues për dhënien e pronës në shfrytëzim, të zbatojë procedurat e cekur në Pikë I të këtij Vendimi, përmes ankandit publik, në pajtim me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, Nr.04/L-144 dhe Rregulloren QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës.
4. Pas marrjes së Vendimit, mbi përzgjedhjen e kompanisë, nga Komisioni vlerësues, në pajtim me procedurat e Ligjit dhe Rregullores QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës do të lidhë kontratë me kompaninë e përzgjedhur më të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e kompanisë.
5. Obligohet Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, që pas përzgjedhjes së kompanisë, nga Komisioni vlerësues, të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Pikën I të këtij Vendimi.
6. Ky vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tij në ueb faqen e Komunës, për realizimin e ti ngarkohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe mbrojtje të Mjedisit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.


  
 REPUBLIKA E KOSOVËS  
 KOMUNA E ISTOGUT  
 Opština Istok  
 UPRAVA OPŠTINE ISTOK  
 Istog Municipality

01-039-3  
 05.4.2018



**KRYESUESI I KUVENDIT**

**z. Qaush Balaj**

*Qaush Balaj*





 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	<b>KUVENDI I KOMUNËS          SKUPŠTINA OPŠTINE          MUNICIPAL ASSEMBLY</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.23/2018	Data: 29.03.2018	


Skupština Opštine, na osnovu člana 12 paragraf 12.2 tačka d) člana 40 paragraf 40.2 tačka e) Zakona o Lokalnoj Samoupravi br.03/L-040 (službene Novien Republike Kosovo br.28/2008) i na osnovu člana 33 paragraf 33.1 tačka 11) Statuta Opštine br 62/2010 i na osnovu člana 3 paragraf 1.3 tačka 1.11 člana 5 i 7 paragraf 3 Zakona o zamjeni i davanja na korišćenje opštinske nepokretne imovine br.04/L-144 i Pravilnikom 23/2013 za utvrđivanje procedura o zamjeni i davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine na sednici održanoj dana 29.03.2018. Razmatra predlog Predsednika Opštine za davanje na kratkoročno korištenje opštinske imovine i donela ovu:



**ODLUKU  
 O DAVANJU NA KORIŠTENJE OPŠTINSKE IMOVINE**

1. Površinu od 9371m<sup>2</sup> sa katastarske parcele nr: 00056-2, Katastarska Zona Vrela, evidentirano pod brojem uverenja 1799/2018, društvena imovina, seosko dobro u Vrela, da se dodeli na kratkoročno korištenje za korištenje kamena za proizvodnju peska za građevinarstvo
2. Vremenski rok za korištenje nepokretne imovine je 15 godina
3. Obavezuje se Komisija za Procenu za davanje imovine na korištenje da sprovodi procedure za davanje imovine na korištenje određenoj u tački -I- ove Odluke, putem javne aukcije, Zakona o zamjeni i davanja na korišćenje opštinske nepokretne imovine br.04/L-144 i Pravilnikom 23/2013 za utvrđivanje procedura o zamjeni i davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine.
4. Nakon donošenja Odluke o odabiru kompanije od Komisije za Procenu, shodno procedurama Zakona i Pravilnika QRK nr.23/2013 za utvrđivanje procedura o zamjeni i davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine, Predsendik Opštien će sklopiti Ugovor sa kompanijom u kojem će se utvrditi prava i obaveze kompanije.
5. Obavezuje se Direktorijat za Urbanizëm Kadtastar i Zaštitu Sredine da nakon odabira kompanije od strane Komisije za Procene, izvrši razgraničenje površine naglašene u tački -I- ove Odluke .
6. Ova Odluka stupa na snagu sedam dana nakon objavljivanja na web stranici Opštine i za realizaciju zadužuje se Direktorijat za Urbanizam, Katastar i Zaštitu Sredine.

Sa kopijom ove Odluke upoznati: Predsednika Opštine, Direktorijat za Urbanizam, Katastar i Zaštitu Sredine i jedna kopija u arhiv Skupštine.

**Predsedavajući skupštine,  
 z. Qatish Balaj**




  
 REPUBLIKA E KOSOVËS - RIKUVA E KOSOVË  
 KOMUNA E ISTOGUT - OPŠTINA ISTOK  
 REPUBLIC OF KOSOVO - MUNICIPALITY OF ISTOG  
 UPRAVA OPŠTINE ADMINISTRACIONE  
 Istog, 03080  
 01-039-3 05-4-2018



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo


Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

### Raport i njësisë kadastrale

Zonë kadastrale: Vrellë  
Lloji i njësisë kadastrale: Parcelë  
Nr i njësisë kadastrale: P-70806008-00256-2



Pika	Y	X
808-86177	7451154.700	4737835.253
808-86178	7451155.070	4737839.050
808-86181	<b>7451181.585</b>	4737839.981
808-75390	7451210.413	4737817.426
808-86180	7451294.488	4737789.740
808-86178	7451316.530	4737708.840
808-86172	7451283.440	4737705.510
808-75398	7451225.802	4737750.934
808-75397	7451165.393	4737783.527
808-75396	7451183.833	4737784.907

Scale: 1:1483

#### Proceset paraprake:

Rasti	ID e Procesit	Lloji i procesit:	Data	Perdoruesi
25/2018	121214	Krijimi i kopjes zyrtare të planit	16.03.2018.	Naim Demaj

Krijuar nga

Pozita:

Emri: Naim

Mbiemri: Demaj

Emri i shfrytëzuesit (kodi): Naim.Demaj

Data: 16.03.2018

Koha: 11:44:01

Nenshkrimi:





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MËDHSIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70806008-00256-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	1799/2018
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	16.03.2018 - 11:53
Komuna / Opština / Municipality:	Istog / Istok / Istog
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	VRELLA / VRELA / VRELLA
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Istog / Istok / Istog

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urdhëno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70806008-00256-2	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shpëtorë / Društvena / Imovina / Socially owned Land	Rural	9371	25/2017	06.10.2017	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostavni adrese Address Details	Krijuar më datën Urdhëno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SHUMA/SHUMA/SHUMA		SHUMA	06.10.2017	





**A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta korisçenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno korisçenja parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvaliteti klase Quality Class	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> ) Površina (m <sup>2</sup> ) Area (m <sup>2</sup> )
1	Take Tjeter/Ostalo Zemljinë/Oberland	Jo Pjellor/Neplodno/Upproductive		9371

**B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Te drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Fojedimori adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posejdim individual / Individualna Društva / single possessor	P.SHE MIRE E FSHATIT VRELLË	KCID9812640	VRELLË / VRELA / VRELLË /		VRELA	1/1		09.10.2017





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



Agjencia Pyjore e Kosovës  
Agencija za Šume Kosova  
Kosovo Forest Agency

Drejtoria Qendrore i Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti

Adresa: Rr. „Ernest Koliqi” pn Prishtinë (përballë EULEX-it )  
Tel. 03820038382; 03820038383

DATE/A:	25.05.2017 26.05.2017
REFERENC-Ë:	Deq. 103 213/17
FËR/ZA/TO:	Kuvendit Komunal në Istog Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - Departamentit për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve komunale
CC:	APK-ës Qendër, dhe Arivcit
FËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Besim ZOGU Drejtor i Drejtoratit Qendror të Inspektionit të Pylltarisë dhe Gjuetisë në APK
NGA/OD/FROM:	Inspektorët: Mehdi Berisha Osman Gashi dhe Xhezair Bibaj
TFMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	VENDIM





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS/ VLADA KOSOVA/ GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



Agjencia Pyjore e Kosovës  
Agencija za Sume Kosova  
Kosovo Forest Agency

Drejtoria Qendrore e Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti

Adresa: Rr. „Ernest Koliqi“ p.n Prishtinë, (përballë EULEX-it)  
Tel. 03820038382; 03820038383

Në mbështetje të Nenit 1, të Nenit 3, Pika (7.4), e Ligjit nr.03/L-153, Nenit 11 pika (26.7) e të njëjtit Ligj, Nenit 27.2 pika (a)-Nenit 23 pikat (a dhe b), Nenit 27.4 dhe Nenit 28.3, Nenit 7 paragrafi 7.1 i cili nën ndërlidhet me Nenin 2 paragrafin 2.1, pikën(f), të Ligjit për Pyjet e Kosovës, 2003/3, Ligjit për Inspektionin e Bujqësisë me nr. 03/L-029 Udhëzimit Administrativ MA-NR 03/2006, për autorizimet ,kompetencat e Inspektionit pyjorë dhe procedurat e nxjerrjes së vendimeve, Neni 3, Pika (13 ,14) dhe Neni 5, Pika (1) i të njëjtit Udhëzim, Udhëzimit administrativ 10/2010 për plotësim-ndryshimin e Udhëzimit administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, Inspektorati Qendror i Pylltarisë dhe Gjuetisë bie:

#### V E N D I M

- I. Obligohet Kuvendi Komunal i Istogut që të revokoj—vendimet e datës 05.05.2017 me Referenca: 65/2017, 66/2017, 67/2017 dhe 68/2017 të Kuvendit të Komunës së Istogut për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të patundshmërive në ngastrat pyjore ku deri më tani në mënyrë të pa ligjshme kanë operuar disa operatorë duke nxjerrë inerte - gurë dhe zhavorr si dhe vendosur pajisje përcjellëse për përpunimin e tij.
- II. Mos zbatimi i këtij vendimi përbënë shkelje ligjore dhe do të sanksionohet në bazë të Ligjeve në fuqi.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Drejtorisë Qendrore të Inspektoratit të Pylltarisë dhe Gjuetisë.
- IV. Vendimi ti dërgohet Kuvendit Komunal në Istog - Kryetarit të Komunës, APK- Qendër, DKR të APK-së në Pejë, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - Departamentit për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve komunale dhe Arkivit

#### A R S Y E T I M

Bazuar në preambulën e këtij vendimi konstatimet Inspektoratit të Pylltarisë se me vazhdimin e më të shpeshëm të shfrytëzimit produkteve pyjore jo drusore (gurit dhe zhavorrit) në ato lokacione janë duke u dëmtuar burimet e ripërtitëshme, duke u dëmtuar prona private, nga rrëshqitjet e dheut si dhe duke u rrezikuar jetët e njerëzve nga reshjet, vërshimet, përmytjet dhe mbushja e gropave me ujë.  
- Inspektorati i pyjeve ka lëshuar vendime me Ref DQIPGJ-150/17 datë 18.04.2017 , Ref DQIPGJ-154/17 datë 18.04.2017 dhe Ref DQIPGJ-171/17 , datë 26.04.2017 për ndërprerje të aktiviteteve të OE dhe për Komunën e Istogut që në bashkëpunim me një anëtarë nga Drejtoria Koordinuese e APK-ës të bëjë vlerësimet e dëmeve të shkaktuara , mirëpo Komuna gjerë më tani nuk kanë reflektuar në zbatimin e përmbyshjes së masave të dhëna. Vendimet e Komunës së Istogut bien në kundërshtim me Ligjin për Pyjet e Kosovës Nr.2003/3 , Nenin 7 , paragrafin 7.1 me të cilën specifikohet se me pyje dhe toka pyjore publike menaxhon dhe administron Agjencia Pyjore e Kosovës i cili është institucion ekzekutiv për pyje publike në

Kosove, kurse Neni 2 i po këtij Ligji te Definicionet e Përgjithshme paragrafi, 2.1 pika (j) sqaron se pyjet dhe tokat publike janë, pyjet dhe tokat pyjore në pronësi shtetërore , shoqërore dhe ato nën kujdesin e UNMIK-ut, pra në rastin në fjalë kemi të bëjmë me toka Shoqërore ( P.S.H.SH) me të cilat sipas Ligjit menaxhon, APK-ës dhe nuk është kompetencë e komunës. Vendimi i Komunës nuk ka asnjë arsyeshmëri logjike dhe Ligjore që përmes procedurave të ankandit publik të jap në shfrytëzim prona që nuk janë në pronësi të Komunës dhe me të cilat nuk menaxhon, me këto veprime më shumë përpigjet të bëj legalizimin e veprimeve të kundërligjshme të kryera nga OE të cilët kanë filluar punimet pa u pajisur me kontrata apo pa vazhduar kontratën e skaduar veprime të cilat bien ndesh me Aktet ligjore që rregullojnë këtë sektor , vendimet e inspektoratit për ndërprerje të çdo aktivitet dhe me obligimet e Komunës sipas Ligjit Nr. 03-L/153 për Plotësim Ndryshimin e Ligjit për Pyje, 2003/3 përmes të cilit ju janë deleguar kompetenca e mbrojtjes së pyjeve dhe për mos marrjen e asnjë veprim deri në përfundimin e punës së Inspektoratit , Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari, z. Beqir Metaj zyrtarisht përmes postës elektronike është njoftuar , nga Drejtori i DQIPGJ, me datë, 26.04.2017. Ky vendim poashtu i referohet Ligjit 03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/3 neni 3 ku thotë: Citoj „Pyjet dhe Tokat Pyjore publike janë pronë e Shtetit të Kosovës”.

Prandaj Inspektorati i Pylltarisë duke pas parasysh faktet e sipërshtënuara, në bazë të Ligjit mbanë të drejtën e marrjes së vendimeve për parandalimin dhe evitimin e parregullsive të mëtutjeshme.

Sic ju theksua më lartë vendimi u soll si në dispozitiv.

Këshilla juridike: Kundër këtij Vendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së këtij vendimi në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

Kontrolloi:

z. Murat RUKOLLI

Udhëheqës i Sektorit të Inspektimit në DQIPGJ